



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0369

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërjen nga Batisha Ibrahim - paneliste individuale, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik OE “Atom - Med” me seli në Prishtinë, kundër Vendimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “13 Furnizimi me materiale stomatologjike, laboratorike dhe RO kabineti” me nr. të prokurimit: "616-24-1242-1-1-1", iniciuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në cilësinë e autoritetit kontraktues (AK), më 04.07.2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar, ankesa e OE “Atom - Med”, e datës 26.04.2024 (Protokolli Nr. 2024/0369), për aktivitetin e prokurimit “13 Furnizimi me materiale stomatologjike, laboratorike dhe RO kabineti” me nr. të prokurimit: "616-24-1242-1-1-1" iniciuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues -Kuvendi i Komunës së Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.
3. Lejohet kthimi i mjetet e depozituara në emrin e tarifës ankimore, kurse ankuesi ka të drejtë të ushtroj kërkesë për kthimin e mjeteve në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Kosovës në përputhje me nenin 118 të LPP, lidhur me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 23.02.2024, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në cilësinë e AK ka publikuar Njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit “13 Furnizimi me materiale stomatologjike, laboratorike dhe RO kabineti” me nr. të prokurimit: "616-24-1242-1-1-1".

Me 08.04.2024, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin (B58) për dhënie të kontratës, duke e rekomanduar për kontratë Operatorit Ekonomik “Atom - Med”.

Me 11.04.2024, OE “Atom - Med” ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim e cila është refuzuar me Vendimin e AK të datës 18.04.2024, me arsyetimin e se pretendimet ankimore të OE ankues janë të bazuara.

Me 26.04.2024, i pakënaqur me vendimin e AK, OE “Atom - Med” ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër të protokollit 2023/0369.

Elementet qenësore të këtij aktiviteti të prokurimit konsistojnë si në vijim: Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim, ndërsa vlera e parashikuar e kontratës për LOT – IV 130,000.00 euro.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprakë -

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Atom - Med” janë parashtruar si në vijim:

Pretendimet Kërkesa e OE ankues vijon si pasojë e një përzgjedhjeje të padrejtë dhe kontraverse nga ana e Autoritetit Kontraktues, lidhur me kërkesat në Dosjen e Tenderit dhe këmbënguljen edhe pas kërkesës për sqarim të paraqitur nga një OE i interesuar për këtë procedurë dhe LOTIN - IV, si dhe pas kërkesës për rishqyrtim. Më datën 08.04.2024, AK dërgoi njoftimin mbi Vendimin për dhënien e kontratës, ku shpalli fitues Grupin e Operatorëve Ekonomik Medila-Humana O.P dhe Flamur Isufi B.I me shumën 92,310.00€. Kriteret për LOTIN - IV përfshinin dëshminë nga prodhuesi i aparatit për reagjentët e ofruar që janë të pranueshëm në aparatet Selectra XS, S, M, Biobase, KeyLab dhe autorizimin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për shitjen e produkteve objekt i kësaj kontrate. AK kërkoi që të ofroreshin reagjentët origjinalë për këto pajisje, pra nga prodhuesi i Selectra, Biobase dhe Keylab. Grupi i OE-ve fitues ofroi reagjentë nga prodhues të tjerë si AMEDA Labordiagnostik GmbH (AMP), HIMEDIA, Centronic BmbH, BioGnost, etj., të cilët janë kompatibilë, por jo origjinalë. Më 05.03.2024, OE Ari Med kërkoi ndarjen në lote për këto pajisje që secili OE të ofronte reagjentët origjinalë për pajisjet specifikuar. Kërkesa u refuzua nga AK, duke thënë se autorizimi nga prodhuesi siguron produkte origjinale për mbrojtjen e pacientit me rezultate të sakta dhe se mund të ofrohet

autorizimi nga prodhuesi ose distributori i autorizuar. Sipas përgjigjes së AK, për këtë lot u kërkuar vetëm reagjentët origjinalë nga prodhuesi i Selectres, Biobases dhe Keylab, ndërsa OE fitues nuk ofroi produkte origjinale por reagjentë kompatibilë, duke mos mbrojtur kështu pacientin.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "Atom - Med" konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me LPP të RK 04/I-042 Neni 1, 7 dhe 28 dhe në kundërshtim me RRUOPP Neni 4.3, 18,8 dhe 19.11.

Përgjigje në kërkesën për Rishqyrtim: Operatori ekonomik "AtomMed" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") paraqiti kërkesë rishqyrtim më 11.04.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 08.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit "13 Furnizimi me materiale stomatologjike, laboratorike dhe RO kabineti" me nr. të prokurimit 616-24-1242-1-1-1. Gjatë shqyrtimit paraprak, u konstatua se kërkesa ishte e lejuar, brenda afatit dhe nga personi i autorizuar, pa pengesa të tjera për shqyrtim. Pretendimet e parashtruesit përfshinin se Grupi i Operatorëve Ekonomik Medila-Humana O.P dhe Flamur Isufi B.I kishte ofertuar me kompani të tjera nga ato që kërkoi AK dhe se i mungonin autorizimet, Declaration of Conformity dhe ISO Çertifikatat nga prodhuesit e Selectres (Elitech), Biobases dhe Keylab, që ishin kritere primare për një OE të përgjegjshëm. Dosja e tenderit dhe oferta e tenderuesit të rekomanduar për LOTIN - IV treguan se ky i fundit kishte dorëzuar autorizimet e prodhuesit sipas kërkesave në dosjen e tenderit. Pretendimet e parashtruesit u konsideruan të pabazuara dhe kërkesa për rishqyrtim u refuzua në tërësi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i prokurimit me datë 03.05.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 369/2024, ndërsa me datë 14.05.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2024/369 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe vendimi i AK të mbetet në fuqi.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues është pajtuar lidhur me rekomandimin e ekspertit, Ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Atom - Med” eksperti shqyrtuese përmes raportit nr. 2024/369 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i ekspertit shqyrtues: Lidhur me pretendimin e OE, autorizimin për aparaturat Selectra XS, S, M, Biobase, KeyLab, dëshmia nga prodhuesi i aparatit për reagjentët e ofruar që janë të pranueshme në këto aparate dhe dokumenteve të dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë, Autoriteti Kontraktues (AK) dhe Komisioni i Vlerësimit i ka analizuar në mënyrë sa më të detajuar, me qëllim që të përmbushin nevojat dhe të zgjidhin problemin e autoritetit kontraktues sa më mirë, më efikas dhe të drejtë për shfrytëzimin e fondeve publike, në pajtim me kriteret e përzgjedhjes dhe kriteret e dhënies të përcaktuara në njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe njoftimin për informata shtesë ose përmirësim të gabimeve.

Autoriteti Kontraktues (AK) – Komisioni i Vlerësimit, ashtu siç e obligon neni 59 i LPP-së, ku thuhet: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.” Andaj, duke marrë parasysh vlerën e parashikuar dhe natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit, autoriteti kontraktues ka analizuar dhe vlerësuar këtë AP bazuar në analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, rrjedhën dhe analizën e procedurës së prokurimit.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve është përgjegjësi dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP, që procesi i vlerësimit dhe krahasimit të bëhet në harmoni të plotë me dispozitat e LPP-së, në mënyrë që të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 në dosjen e tenderit si dhe të respektohen kriteret e dhënies. Prandaj, duke u bazuar në këto fakte dhe analiza e mësipërme, vlerësoj se ky pretendim ankimor është pjesërisht i qëndrueshëm.

Eksperti shqyrtues ka sqaruar se autoriteti kontraktues është i obliguar të sigurojë që fondet dhe burimet publike të përdoren në mënyrë sa më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin e lëndës së prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, transparente dhe të drejtë për shfrytëzimin e fondeve dhe burimeve publike

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit

lidhur me aktivitetin e “13 Furnizimi me materiale stomatologjike, laboratorike dhe RO kabineti” me nr. të prokurimit: "616-24-1242-1-1-1". Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Atom - Med” dhe se argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Paneli Shqyrtues, duke marrë në konsideratë raportin e ekspertit dhe dokumentet relevante të tenderit, ka vendosur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “13 Furnizimi me materiale stomatologjike, laboratorike dhe RO kabineti” me nr. të prokurimit: "616-24-1242-1-1-1", të mbetet në fuqi vendimi i AK-së. Paneli Shqyrtues konstatoi se ankesat e Operatorit Ekonomik ankues ishin pjesërisht të bazuara. Autoriteti Kontraktues (AK) ka vepruar në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), duke respektuar kërkesat e përzgjedhjes dhe specifikimet teknike. Procesi i vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nga Komisioni i Vlerësimit ishte në harmoni të plotë me dispozitat e LPP-së. AK është i obliguar të sigurojë përdorimin ekonomik të fondeve publike, duke marrë parasysh qëllimin e prokurimit, siç parashihet në nenin 6 të LPP-së dhe nenin 1 të LPP-së, për një përdorim efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike. Në përfundim, Paneli Shqyrtues vendosi që ankesa e OE "Atom - Med" të aprovet pjesërisht dhe vendimi i AK të mbetet në fuqi gjithmonë duke u bazuar në analizat dhe faktet e paraqitura.

Paneli shqyrtues ka analizuar përgjigjen e OE Ankues në raportin e ekspertizës lidhur me rezultatet e analizave laboratorike tek pacientët, i mbetet në përgjegjësi të AK-se për mbrojtjen e interesit publik, lidhur me pranimin e furnizimeve me reagenca dhe materiale për çka është iniciuar ky aktivitet.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtuese lidhur me plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në baze të nenin 117 të LPP-së, u vendos si në diapozitivin e këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale-Departamenti Administratë nëafat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Atom - Med**
- Arkivës së OSHP-së: